



Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri

Data: 23/05/2025

TERMA REFERENCE

Psikolog për prindër të fëmijëve me aftësi të kufizuara

Organizata	Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri
Adresa:	Rr. "Nikolla Tupe", P. 2/4, Ap. 15, Tiranë, Shqipëri.
E-mail:	genderjusticealbania@gmail.com
Pozicioni i punës së kërkuar:	Psikolog për prindër të fëmijëve me aftësi të kufizuara
Lloji i kontratës:	Kontratë Shërbimi
Periudha e kontraktimit:	Qershor 2025 – Maj 2026
Data e mundshme e fillimit të punës:	Qershor 2025
Zona gjeografike:	Bashkia Vlorë
Afati i dorëzimit të aplikimit:	13/06/2025

1. HYRJE

Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri (QDGJSH) është një organizatë jofitimprurëse, e pavarur, jo-politike, e cila punon për fuqizimin e grave dhe vajzave, mbron të drejtat e tyre dhe lufton pabarazitë gjinore. QDGJSH është themeluar me iniciativën e tre grave aktiviste të shoqërisë civile të cilat, prej më tepër se 15 vitesh, kontribuojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të grave në Shqipëri. QDGJSH është regjistruar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë me vendimin nr. 1738, datë 28/06/2022. Sipas legjislacionit në fuqi, QDGJSH është regjistruar edhe pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, Tiranë me nr. NIPT: M22002451K.

QDGJSH po zbaton në Bashkinë Vlorë projektin “Ofrimi i shërbimeve të specializuara të kujdesit social për fëmijët, të rinjtë me aftësi të kufizuara dhe prindërit e tyre në Bashkinë Vlorë”, në kuadër të programit “BE për Kujdesin Social”, financuar nga Bashkimi Evropian, zbatuar nga UNICEF Shqipëri dhe World Vision Shqipëri, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri

Rr. "Nikolla Tupe", P. 2/4, Ap. 15, Tiranë, Shqipëri

Web: www.gjalbania.org; email: genderjusticealbania@gmail.com; Tel: +355692667531



Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri

Në kuadër të projektit, QDGJSH po asiston bashkinë Vlorë për të ngritur një Qendër Ditore për ofrimin e shërbimeve të kujdesit social për fëmijë dhe të rinj me aftësi të kufizuara dhe po kërkon të kontrakttojë një Psikolog për prindër të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

2. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË KRYESORE

- Ofron shërbimin individual psikologjik (këshillim dhe/ose asistencë) për prindër të fëmijëve me aftësi të kufizuara.
- Mban dhe plotëson në mënyrë të plotë dosjen personale të përfituesit të shërbimit.
- Dokumenton shërbimin e ofruar dhe raporton mbi progresin e arritur për secilin nga rastet e trajtuara te Koordinatori i Qendrës së Kujdesit Ditor.
- Përgatit raporte mujore mbi shërbimin e ofruar për stafin drejtues të projektit.

3. KUALIFIKIME DHE AFTËSI TË KERKUARA

- Diplomë universitare në Fakultetin e Shkencave Sociale, dega Psikologji.
- Të paktën 3 vjet eksperiencë në punë si psikolog.
- Aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për të punuar në grup.
- Aftësi shumë të mira komunikuese.
- Aftësi për ruajtjen e konfidencialitetit të rasteve që trajton.

4. PROCESI I APLIKIMIT

Aplikantët e interesuar duhet të dërgojnë me shkrim në adresën elektronike, dorazi ose adresën postare të Qendrës për Drejtësi Gjinore dokumentacionin e poshtëshënuar:

- Curriculum Vitae (përfshirë kontakte për referenca të punëdhënësve të mëparshëm);
- Dokumente që vërtetojnë edukimin (kopje e diplomës universitare, master, etj.);
- Letër motivimi.
- Ofertë financiare në monedhën LEK për ditë pune.

Adresë elektronike: genderjusticealbania@gmail.com; adena.vangjeli@gjalbania.org

Adresë postare: Rr. "Nikolla Tupe", P. 2/4, Ap. 15, Tiranë, Shqipëri.

5. AFATET

Afati për dërgimin e aplikimeve: 13/06/2025.

Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri

Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri

Rr. "Nikolla Tupe", P. 2/4, Ap. 15, Tiranë, Shqipëri

Web: www.gjalbania.org; email: genderjusticealbania@gmail.com; Tel: +355692667531